



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI KOMBETAR I UJIT
KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES "VJOSA", VLORE

VENDIM

Nr. 5, Dt. 06.08.2007

Per miratim te kerkeses, si propozim i pa kerkuar, per perdorimin me koncension, te burimit uJOR "Pusi Nr.1 Frashtan", komuna Dropulli i Poshtem, prej subjektit "Fresh Compani" sh.p.k. Gjirokaster.

Ne zbatim te kerkesave te Ligjit Nr.8093 Dt.21/03/1996 "Per Rezervat Ujore" te percaktuara ne nenet 8 dhe 16 dhe Vendimit Nr.289 te K..M Dt. 15/04/2005, pika 2 dhe pika 9/B, "Per percaktimin e kerkesave, te procedurave per miratimin e lejeve , te autorizimeve dhe koncensioneve per perdorimin e ujit", si dhe vendimiot nr.21, dt. 01.08.2006 te K.B.U Vjose, K.B.U "Vjose",

VENDOSI:

1. Miratimin e kerkeses, te subjektit "Fresh Compani", sh.p.k, Gjirokaster, si propozim i pa kerkuar, per perdorimin me koncension te burimit uJOR "Pusi Nr. 1 Frashtan", komuna Dropulli i Poshtem, prej subjektit "Fresh Compani" sh.p.k. Gjirokaster.

Me koordinata:

X = 44 27 542 Y = 44 35 122 Z = 200 m

2. Sasia e ujit qe jepet ne perdorim do te jete 5 l/sek
3. Ngarkohet A.U.B "Vjose" Vlore per zbatimin e ketij vendimi.
4. Ky vendim hyne ne fuqi menjehere.

PERGJEGJESI I A.U.B "VJOSE"

Vezir METAJ



KRYETARE E K.B.U-se

Dorothe KONOMI

